

STATUTI
DHE
AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË
“OpGenius” SH.P.K

Sot me 04/08/23 “Victoria Venture Capital Sh.p.k.”, një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me numër identifikimi NUIS M31919019L me adrese Rruga Ibrahim Rugova, zona kadastrale 8270, pallati numër 68, kati 5 apartamenti 22, Tirane” përfaqësuar nga administratori znj. Selenja Robo miraton aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë OpGenius Sh.p.k si vijon:

KREU I
EMËRTIMI – SELIA – OBJEKTI - KOHËZGJATJA

Neni 1

Emërtimi

- 1.1** Shoqëria emërtohet “**OpGenius**” (në vijim referuar si “**Shoqëria**”).
- 1.2** Emërtimi i Shoqërisë ndiqet nga akronimi “**Shpk**”, sipas kërkesave të ligjit Nr. 9901, Datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (në vijim referuar si “**Ligji Tregtar**”) në përputhje me formën e saj juridike, sipas nenit vijues.
- 1.3** Shoqëria ka logon dhe vulën përkatëse, të cilat vendosen në çdo dokument të saj.

Neni 2

Forma Juridike

- 2.1.** Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.
- 2.2.** Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe me këtë Statut.

Neni 3

Selia

3.1. Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën:

“Rruga Ibrahim Rugova, zona kadastrale 8270, pallati numër 68, kati 5 apartamenti 2, Tirane.”

3.2. Administratori mund të hapë dhe/ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat do të ushtrorjnë veprimtarinë sipas kompetencave dhe kufizimeve të vendosura nga Ortaku i Vetëm dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Kohëzgjatja

4.1. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

4.2. Prishja, likuidimi dhe shpërbërja e Shoqërisë do të përcaktohen me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

4.3. Shoqëria mund të priset gjithashtu për shkaqe të ndryshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të pavarura nga vullneti i Ortakut të Vetëm.

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

5.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por nuk do të kufizohet në:

Konsulencë dhe ndihmë në fushën ekonomike dhe të së drejtës së punës në sipërmarrje dhe shoqëri, fiskale, tatimore e ligjore, kontabël, administrative dhe manaxhuese, përfshirë këtu, por pa u kufizuar vetëm në to:

- mbajtjen, edhe në mënyrë “outsourcing”, e kontabilitetit të përgjithshëm dhe TVSH të se gjitha detyrimeve administrative dhe të kontrollit përkatëse, duke iu referuar veçanërisht strukturimit të planit të llogarive, mbajtjes së kontabilitetit analitik dhe menaxhues, përpilimit të raporteve kontabël, përpilimit të bilancit (edhe atij të konsoliduar), mbajtjen, ndër të tjera, të regjistrimit të inventarit dhe të regjistrave të trupëzimeve, mbështetje gjate kontroleve periodike të bordit mbikëqyrës dhe të shoqërive të auditimit dhe asistencë në adoptimin e parimeve kontabël ndërkombëtare;
- mbajtjen e regjistrave të shoqërisë dhe të regjistrave të tjerë të detyrueshëm apo jo dhe veprimet përkatëse, përfshirë këtu asistencën në mbledhjet e organit administrativ dhe të asamblesë me mbajtjen e proces verbaleve përkatëse, menaxhimin e veprimtarive për aprovimin e bilancit dhe të vendimeve vijuese, administrimin e emërimeve dhe të rinovimit të organeve të shoqërisë, kryerjen e veprimeve pranë zyrave publike, mbështetjen e sekretarisë së shoqërisë në veprime të jashtëzakonshme si bashkime, përthithje, etj.;

- marrjen e mandateve per përfaqësim;
- konsulencë ne fushën e planifikimit dhe kontrollit te administrimit, duke iu referuar në mënyrë te veçantë vlerësimit dhe projektimit të sistemeve te planifikimit dhe kontrollit të shoqërisë, mbështetës në veprimtaritë e “Budget” dhe “reporting”, ne projektimin dhe menaxhimin me “outsourcing” të sistemeve të raportimit te veprimtarive te shoqerise, në projektimin dhe implementimin e politikave të kontrollit dhe analizës së “performancave” të shoqërisë;
- konsulencën mbi modelet organizuese dhe sistemet e kontrollit, duke iu referuar analizës dhe ri projektimit të proceseve të shoqërisë, përpunimin dhe/ose rishikimin e procedurave dhe “policy” organizuese, mbështetje në aktivitetet e “internal audit” dhe të formatizimit dhe adoptimit të modeleve organizuese në bazë të Dekretit Legjislativ nr. 23 1/01, Ligjit nr. 262/05 dhe Dekretit Legjislativ nr. 231/07;
- vlerësimin e sipërmarrjeve dhe subjekteve të tjera pasurore ne përgjithësi dhe kryerjen e “due diligence” me përjashtim të rasteve kur bëhet fjale per veprimtari të rezervuara;
- veprimtaritë e administrimit, menaxhimi dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, duke iu referuar veçanërisht përpunimit te llogarive ,të rrogave dhe te përmbushjes se detyrimeve përkatëse, përgatitjes se buxhetit të kostos se punës, përpilimit të raporteve drejtuese, arkivimit optik të dokumenteve per përpiluar, veprimtarive mbështetëse dhe këshillimore lidhur me sistemimin e organikes, proceseve të vlerësimit dhe matjes së performancave personale, përcaktimit te nevojave dhe planifikimit të veprimtarive formuese dhe menaxhimit të sistemit të vlerësimit dhe të dhënies së çmimeve;
- realizimin, tregtimin, menaxhimin, dhënien në përdorim dhe mirëmbajtjen e sistemeve informatike dhe te programeve per përdorues elektronike;
- organizimin e personelit, të pajisjeve te zyrave dhe te mjeteve te tjera materiale apo ndihmese me qellim vënien në dispozicion të profesionisteve apo shoqërive, zyrave të mobiluara dhe funksionale (sekretari, pajisje edhe të kompjuterizuara, organizim i mbledhjeve);
- organizimin e kurseve te formimit dhe seminareve edhe online, në përputhje me/ legjislacionin në fuqi, prodhimin dhe tregtimin e publikimeve (përjashtuar gazetate), te moduleve dhe materialeve te ndryshme, lidhur me shërbimet e dhëna dhe, në përgjithësi, lidhur me menaxhimin e shoqërive;
- analizën, prodhimin, furnizimin, tregtimin, instalimin, ripërdorimin dhe menaxhimin e programeve dhe sistemeve “software”, si bazë ashtu edhe aplikative të përgjithësuar dhe/ose per tregje te posaçme, dhe projektimin e ndërtimin e sistemeve informatikë dhe telematikë, per administrimin e personelit dhe menaxhimin e fondeve të pensionit dhe të fondeve per sigurimet dhe veprat e shërbimet përkatëse;
- ideimin, realizimin, furnizimin dhe shitjen e çdo produkti/shërbimi/konsulence dhe asistencën përkatëse edhe nëpërmjet “call-center” per subjekte dhe private Lidhur me administrimin dhe menaxhimin e personelit, menaxhimin e fondeve të pensionit dhe fondeve të sigurimeve dhe veprave e shërbimeve përkatëse;
- realizimin, blerjen, shitjen dhe qiradhënien e “software”-ve, të aparateve elektronike dhe pajisjeve e aksesorëve dhe të licencave software, si edhe prodhimin, tregtimin, qiradhënien e produkteve hardware te veta apo te blera nga të tretë me shërbimin e asistencës përkatëse teknike;

- asistencë teknike dhe mirëmbajtje të “software”;
 - përdorim i sistemeve telematike (p.sh. “internet”) për marrjen dhe transmetimin e të dhënave;
 - përdorim dhe menaxhim i përpunuesve të së dhënave, regjistruar dhe pajisjeve të tjera për përpunimin e të dhënave të veta dhe/ose për llogaritë të tjerë;
 - analizë, programim dhe ofrim shërbimesh përpunimi të përgjithësuara në sektorët e punës, social dhe ekonomik, nëpërmjet kryerjes së çdo veprimtarie të nevojshme;
 - organizimi dhe kryeria e veprimtarive menaxhuese, vlerësim formimi dhe trajnim i personelit, si edhe organizim i shoqërisë, dhe çdo veprimtari lidhur me to.
- 5.2.** Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin dhe përkojnë me arritjen e qëllimit të veprimtarisë së saj, në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.
- 5.3.** Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet, përditësohet, plotësohet në çdo moment, me vendim të Ortakut të Vetëm.

KREU II KAPITALI DHE KUOTA

Neni 6

Kapitali

- 6.1.** Kapitali i Shoqërisë është 10.000 Leke (dhjetëmijë lekë).
- 6.2.** Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar tërësisht dhe përbehet nga 1 (një) kuotë, në përputhje me nenin 7 vijues.

Neni 7

Ortakët

- 7.1.** Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është:

“**Victoria Venture Capital Sh.p.k.**”, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me numër identifikimi NUIS M31919019L me seli në adresën “Rruga Ibrahim Rugova, zona kadastrale 8270, pallati numër 68, kati 5, apartamenti 22, Tirane”, zotëruese e një kuote të barabartë me 10.000 Leke (dhjetëmijë leke) dhe 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 8

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 8.1.** Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 8.2.** Shoqëria në çdo kohë mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e vlerës së kapitalit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi, cilësuar si Ligji Tregtar.

- 8.3.** Kontributi i mëtejshëm në kapitalin e Shoqërisë mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme, kuota apo të drejta). Mënyra e shlyerjes së kontributeve do të përcaktohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 9

Transferimi i Kuotës

- 9.1.** Ortakët mund të vendosin në çdo kohë për pjesëtimin dhe transferimin e kuotës përmes shitjes, dhurimit, transferimit me rrugë trashëgimie apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
- 9.2.** Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, Ortaku i Vetëm përcakton kushtet, momentin e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, momentin e pagesës së çmimit, në kontratën e kalimit të kuotës, e cila hartohet në formë shkresore, sipas dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm.

KREU III ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 10

Organet e Shoqërisë

- 10.1.** Organet e Shoqërisë janë si vijon:
- Ortaku i Vetëm – organi më i lartë vendimmarrës;
 - Administratori/ët – organi më i lartë ekzekutiv.

KREU IV VENDIMMARRJA DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 11

Vendimmarrja

- 11.1.** Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm.
- 11.2.** Ortaku i Vetëm është përgjegjës, ndër të tjera, për vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:
- (i) përcaktimin e politikave të biznesit të Shoqërisë;
 - (ii) ndryshimin, modifikimin, plotësimin e statutit;
 - (iii) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, vendosjen dhe ndarjen e kompetencave të tyre, si dhe shpërblimin përkatës;
 - (iv) zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit;
 - (v) transferimin e kuotave;

- (vi) shpërndarjen e fitimeve;
- (vii) riorganizimin, prishjen dhe/ose likuidimin e Shoqërisë; dhe
- (viii) çdo çështje tjetër të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm dhe ky Statut.

Neni 12

Regjistri i Vendimeve

- 12.1.** Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
- 12.2.** Duhet të regjistrohen në veçanti, vendimet e mëposhtme:
- i. miratimi i pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ii. shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve;
 - iii. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
 - iv. vendime në lidhje me investimet;
 - v. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.

Neni 13

Administrimi

- 13.1.** Shoqëria mund të administrohet nga një apo disa administratorë, numri dhe kompetencat e të cilëve do të përcaktohen me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 13.2.** Administratori/ët do të emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtë.
- 13.3.** Administratori/ët zgjidhen në përputhje me kërkesat ligjore dhe kufizimet e Ligjit Tregtar.
- 13.4.** Administratorët janë persona fizikë, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë.
- 13.5.** Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin 5 (pesë) vjeçar.
- 13.6.** Kohëzgjatja e mandatit të administratorit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Ortakut të Vetëm, pa kufizim.
- 13.7.** Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë z. Gjergji Robo shtetas shqiptar, lindur me 18.05.1984, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I40518067I me një mandat 5-vjeçar duke nisur nga data e themelimit të Shoqërisë.
- 13.8.** Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Ortakut të Vetëm, i cili duhet të caktojë një administrator të ri apo të ndajë kompetencat ndërmjet administratorëve të mbetur (në rastin kur Shoqëria ka disa administratorë).

- 13.9.** Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e Shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas legjislacionit të zbatueshëm.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1.** Administratorët janë përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë me palët e treta, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, vendimet e Ortakut të Vetëm dhe legjislacionin e zbatueshëm.
- 14.2.** Kompetencat dhe detyrat e administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:
- a. zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Ortakut të Vetëm;
 - b. kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
 - c. sigurimin e mirëmbajtjes së rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabël të Shoqërisë;
 - d. sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin dhe standardet e kontabilitetit nga Shoqëria;
 - e. përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të cilat paraqiten përpara Ortakut të Vetëm për miratim;
 - f. raportojnë përpara Ortakut të Vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
 - g. përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
 - h. njoftojnë Ortakun e Vetëm menjëherë për çdo çështje që kërkon vendimmarrjen e tij;
 - i. kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, që kërkohen sipas legjislacionit në fuqi;
 - j. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; dhe
 - k. kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm dhe në këtë Statut.
- 14.3.** Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe nga ky Statut janë të rezervuara për Ortakun e Vetëm.
- 14.4.** Administratori mund të veprojë vetëm duke marrë parasysh interesin më të lartë të Shoqërisë.

KREU V
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 15

Audituesi Ligjor

- 15.1.** Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël të Shoqërisë do t'u besohet një ose me shumë audituesve ligjorë dhe/ose kontabilistëve të miratuar.

Neni 16

Viti Financiar dhe Pasqyrat Financiare

- 16.1.** Viti ushtrimor financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.
- 16.2.** Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe audituesit ligjor/ kontabilistit të miratuar, nëse ka një të tillë, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me Ligjin Tregtar.

Neni 17

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

- 17.1.** Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit të saj, sipas dispozitave të Ligjit Tregtar.
- 17.2.** Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar tagrat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mund t'i shkarkojë apo zëvendësojë në të njëjtat kushte.
- 17.3.** Administratori/ët i Shoqërisë i njofton për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit, të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre për të përfaqësuar Shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse.
- 17.4.** Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.
- 17.5.** Nëse Shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas ligjit të zbatueshëm. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.
- 17.6.** Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të pa arkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
- 17.7.** Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se 1 (një) vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Ortaku i Vetëm.

17.8. Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi. Gjatë kësaj procedure, togfjalëshi “në likuidim e sipër” duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.

Neni 18

Të Dhëna të Detyrueshme gjatë Kohëzgjatjes së Shoqërisë

18.1 Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga Shoqëria, degët apo zyrat eventuale të përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- numrin unik të identifikimit;
- formën ligjore të shoqërisë;
- vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
- të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
- vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit.

18.2. Nëse Shoqëria krijon edhe një faqe interneti, këto të dhëna do të pasqyrohen aty.

Neni 19

Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

19.1. Ky akt bazohet ne legjislacionin Shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, duhet të kryhen në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar.

19.2. Për sa nuk parashikohet në këtë akt do të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi, e në veçanti ato të Ligjit Tregtar.

19.3. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij akti do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje autentike, në gjuhën Shqipe.

ORTAKU I VETËM

I SHOQËRISË “OpGenius” SH.P.K

Selenya Robo

